

DOSSIER: NJË NGJARJE E HARRUAR, PËR TË CILËT ËSHTË SHKRUAR DHE FOLUR PAK. 20 VJET MË PARË, NË NDESHJEN

Fundi i një diktature:

Nga Jorgis MEMO

Plasi në Kuçovë! Eshtë kjo batuta e famshme e filmit "Gjeneral Gramafoni", që me kalimin e kohës mori përmasa të një ngjarjeje reale, e nisur

nga një ndeshje futbollit. Eshtë pikërisht ajo midis Naftëtarit dhe Dinamos, më 5 qershor të vitit 1988, në ish-qytetin Stalin, sot Kuçovë. Batuta e filmit u rikthye në atë vit, pas revoltës së popullit të Kuçovës, menjëherë

pas ndeshjes. Një revoltë e papritur, e cila për atë periudhë ishte e paimagjinueshme. Për kohën ishte një shkëndijë e madhe zgjimi, sepse pas dy vjetësh rezultoi me rënien e regjimit komunist. Pra, gjithçka

erdhi pas një ndeshjeje futbollit, për të cilën është shkruar fare pak. Tashmë, kur kanë kaluar 20 vjet, "Sporti shqiptar" kërkon të hedhë dritë mbi këtë ngjarje. Janë dy nga protagonistët e vërtetë: Besnik

Kaimi, gjyqtari i ndeshjes, si dhe portieri i Dinamos, Ilir Bozhiqi, ata që flasin. Gjithashtu, duke shfletuar edhe shtypin e huaj, është përzgjedhur shkrimi i gazetarit italian Xhovani Armiota.

Revokim i një ndeshjeje dy dekada më parë: Naftëtari-Dinamo 0-1 dhe rënia e stalinizmit në botë dhe në Shqipëri

Një ndeshje futbollit dhe fundi i një epoke

Nga Xhovani ARMIOTA

Nuk bëhet fjalë për ndonjë ndeshje koti, të marrë rastësisht midis shumë të tjerave. Do të flasim për një nga krizat më serioze që kaloi Shqipëria dhe që sot konsiderohet shkëndija që ndezi trazirat e 1991, deri në 1996 dhe fillimin e vitit '97. Më 4 dhjetor 1997 isha në Tiranë, në cilësinë e ekspertit për historinë shqiptare dhe marrëdhëniet publike për llogari të një kompanie toscane. Kjo e fundit ishte në dijeni të marrëdhëniet të mira që unë kisha me institucionet shqiptare që në fillim të viteve '70. Po atë mbrëmje fillova të flas për futbollin në hollin e hotel "Tiranës", me një tifozi të vjetër. Diskutuan nga ora 20:00 deri në 1:00 të natës mbi historinë e futbollit shqiptar. Tifozi i moshuar ishte i mrekulluar se si një i huaj, për më tepër i ri, njihje gjëra rreth sportit që "as një shqiptar nuk i dinte ose nuk i mbante mend kaq mirë." Tifozi më premtoi që ditën tjetër do të më sillte shkrimin, që nuk u shkrua kurrë, të një ndeshjeje, tashmë të harruar nga të gjithë. Unë nuk mund ta imagjinoja për cilën ndeshje bëhej fjalë. Mendoja se e kishte fjalën për ndeshjen Traktori-Labinoti, me rezultatin 0-3, për të dyja sezonet 1965-66, ose 17 Nëntori-Partizani, po ashtu 0-3 (1966-67), por në fakt e kisha gabim.

Një natë më vonë, në orën 20:00, tifozi i moshuar, më solli gazetën, më përshëndeti duke ikur, por jo pa më thënë që ishte nga ish-Qyteti Stalin, i vendosur në Shqipërinë e Mesme, tashmë Kuçovë, që pas viteve '90. Vetëm pasi lexova letrën, e kuptova që nuk dija emrin e atij fansi të futbollit. Naftëtari, skuadra e Qytetit Stalin, në sezonin 1986-87 ra në kategorinë e dytë. Në fund të sezonit 1987-88 doli e dyta, dhe sipas rregullores duhet të ndeshet me Dinamon, e katërta nga fundi në kategorinë e parë. Dinamo, skuadra e Ministrisë së Brendshme dhe policisë së shtetit, 14 herë kampionë e Shqipërisë, 10 herë fituese e Kupës së Republikës dhe 3 herë e Spartakiadës Kombëtare, atë sezon ishte shumë dobët. Në Tiranë, 2 qershor 1988, Dinamo fitoi 1-0, me mbështetje nga ana e arbitrave. Në ndeshjen e kthimit në Qytetin Stalin (5 qershor) Dinamo u shokërua me një kamion ushtarak të forcave të policisë dhe ndërhyrjes së shpejtë. Në fakt, që nga ajo ndeshje, lajuar në Qytetin Stalingrad shqiptar, nomenklatura e fundit staliniste në botë filloi të çalonte. Nga ana tjetër, situata ekonomike në Qytetin Stalin, dhe në qytete të tjera shqiptare, jo të mëdha, ishte shumë e rëndë. Familjet kishin të drejtë vetëm për 5 kokra vezë, një kile mish, dhe një ose dy djath, plus një qese kafe 100 gramë. Po le të kthehemi tek ndeshja. Arbitri bëri një drejtim të njëanshëm, specifike

Storia

Albania, Città Stalin: una partita di calcio e la fine di un'era

Da Naftëtari-Dinamo 0-1 alla caduta dell'ultimo regime stalinista al mondo

«Dinamo» mbetet në kategorinë e parë

«Dinamo» mbetet në kategorinë e parë... (Text continues with details of the match and its significance.)

La partita cominciò al spigno

Il 20 febbraio 1988, il presidente dell'Assemblea Popolare, Ramiz Alia, decise di convocare il governo provvisorio Fatos Nano I al posto di Mehmet Shehu...

Faqja e gazetës së përditshme "Rilindja", që botohet në Romë, ku gazetari Xhovani Armiota ka botuar shkrimin në fjalë

për ndeshje të Dinamos. Menjëherë protestuan futbollistët dhe pastaj, në mënyrë fragmentare, publiku. Forcat e policisë u shpërndanë në dhomat e zhveshjes në mbrojtje të futbollistëve të Dinamos. Lajmi doli jashtë stadiumit dhe pati përleshje nëpër rrugë. Qytetarët e Qytetit Stalin (jo vetëm tifozët e Naftëtarit) me pretekstin për të kundërshtuar drejtimin e ndeshjes, për herë të parë në historinë e Shqipërisë komuniste inskenuan një protestë të madhe kundër regjimit në Tiranë. Arritën deri aty sa i vunë zjarrin një makine të policisë. Ndërkohë, forcat e rendit protestuan dhe morën në mbrojtje lojtarët e Dinamos dhe treshen e gjyqtarëve. Në të njëjtën kohë, agjentët e Qytetit Stalin bënë shumë arrestime, që sollën ditën tjetër procese, madje edhe kryebashkiaku pati probleme. Federata Shqiptare e Futbollit ra dakort me Komitetin Qendror të Partisë së Punës dhe kualifikoi Naftëtarin, si përgjegjës për sezonin 1988-89, duke e lënë të rifillonte nga kategoria e dytë në 1989-90. Qyteti Stalin, qendër e nxjerrjes së naftës dhe qytete të tjera të vogla të Shqipërisë, ishin lënë në një gjendje varfërie totale, ndërkohë që Tiranë, Durrësi, Elbasani, Shkodra, Vlora, etj., trajtoheshin më së miri. Prandaj, Partia e dinte që ndodhej para një dileme: ose ta linte Dinamon në fatin e saj, duke pranuar paaftësinë e vet, ose ndoshta një fitore e Naftëtarit do të prezantonte shpërblimin e atyre që vlenin disi. Zgjedhi të dytën, ndërkohë që në rastin e parë promovimi i Naftëtarit, ndryshe nga shumë çështje shqiptare, nuk mund t'u fshihej qytetarëve. Incidentet nuk ishin sigurisht fryt i një rrjeti, por shprehja e një gjendjeje të keqe, të përgjithshme, që ishte shpërndarë në gjithë vendin. Ministria e Brendshme, përveç të tjerash, gaboi në shpërndarjen e forcave speciale. Në fakt, ato nuk ishin shpërndarë me kujdes para ndeshjes, prandaj qytetarët pritën paraprakisht një ndërhyrje të ushtrisë. Një makinë e policisë u vendos midis Lushnjës e Beratit, një tjetër midis Fierit dhe Beratit, gjithashtu një tjetër kamionçinë, me 30 veta, u vendos tek Ura Vajurore, 3 kilometra nga Qyteti Stalin, dhe kryqëzimin midis 3 qyteteve të sipërpërmendura. Në Shqipëri çështjet e sportit (sidomos futbollit) shpesh lidhin politikën me ngjarje të rëndësishme. Mjafton të mendosh 13 shtatorin 1986, katër ditë para ndeshjes së Kupës UEFA Flamurtari-Barcelona 1-1. Agjencia Telegrafike Shqiptare njofton se Tirana dhe Madridi kishin rënë dakort për të vendosur marrëdhënie diplomatike të një niveli të lartë. Në 1 tetor ndeshja e kthimit me Barcelonën përfundoi 0-0, dhe skuadra e Vlorës u eliminua, për shkak të golit në transfertë të spanjollëve. Më 6 dhjetor, ndërkohë që isha në avionin Tiranë-Romë, e rilexova shpesh atë dokument, një dëshmi e rëndësishme dhe historike e atyre fakteve misterioze dhe të dhunshme, të ndodhura gjatë ndeshjes Naftëtari-Dinamo 0-1. Me t'u kthyer në Pizë, u zhyta në arkivin tim personal dhe duke shfletuar, më 6 qershor 1988, numrin e gazetës "Sporti popullor", duke parë komunikatën që lajmëronte qëndrimin permanent të Dinamos në kategorinë e parë, mendova: "Më mirë mos fol sesa të gënjesh." Por që nga ai 6 qershor morën rrugën ndryshime të shpejta...

Marrë me shkurtime nga "Rilindja", e përditshme e Romës 11 qershor 2006

NAFTËTARI-DINAMO U PARALAJMËRUA FUNDI I NJË EPOKE QË RRËZOI NJË REGJIM DIKTATORIAL

Plasi në Kuçovë!

Rrëfhet gjyqtari i ndeshjes Naftëtari-Dinamo, Besnik Kaimi. Ja çfarë ndodhi në Kuçovë, më 5 qershor të vitit 1988

Futbolli u shfrytëzua për politikë



Gjyqtar ndërkombëtar, Besnik Kaimi, që gjyko ndeshjen Naftëtari-Dinamo 0-1

Ishte 5 qershori i vitit 1988, kur ndeshja Naftëtari-Dinamo mori përmasa të mëdha, duke u kthyer në një revoltë popullore. Kjo përballje pritej me shumë interes në qytetin e Kuçovës, sepse Naftëtari luante për "jetë a vdekje". Dy ekipet diskutonin qëndrimin në kategori, teksa ndeshja e parë kishte përfunduar 1-0 për Dinamon. Por çfarë ndodhi realisht në Kuçovë? A u shfrytëzua futbolli, si sporti më i dashur, për politikë? Si ishte situata para ndeshjes dhe çfarë u bë brenda dhe jashtë fushe? Për të gjitha këto, në një rrëfim ekskluziv për "Sportin shqiptar", ish-gjyqtari Besnik Kaimi, njeriu që ka përjetuar më shumë se kushdo këtë ngjarje, tregon gjithçka, duke hedhur dritë mbi këtë çështje të diskutuar shumë në atë periudhë.

"Ndeshja dhe gjendja e rëndë ekonomike"

"Kam jetuar për pak vite në Kuçovë, sepse kam kryer shërbimin ushtarak, madje kam luajtur edhe futboll me Naftëtarin. Prandaj, e di mirë se në çfarë gjendjeje ka qenë Kuçova në vitet 70-të. Aty jetonin familje të ngritura dhe erdhi një moment që ato u ngacmuan nga ana ekonomike. Kjo e fundit u rëndua shumë dhe ishte pikërisht ndeshja Naftëtari-Dinamo, ajo që shënoi shpërthimin e kësaj revolte popullore. Mbjaj mend që një ditë pas ndeshjes ishte planifikuar që të zhvillohej edhe Kongresi i Gruas në atë kohë. Çdo gjë ishte e qartë: hidhërimi i popullit nuk erdhi nga futbollit, por nga rregjimi komunist. Brenda fushës nuk ka pasur ndonjë episod, i cili mund të linte shkas për të revoltuar njerëzit."

"Ministria kërkonte fitoren e Dinamos"

"Në atë kohë isha në zbor dhe më erdhën në repart. Pasi arrita të merrja leje, më morën me makinë dhe shkuam në Tiranë. Këtu më priti Kryetari i Komitetit të Fiskulturës në atë kohë, Josif Devole. Ky i fundit më komunikoi që je emëruar gjyqtar i ndeshjes Naftëtari-Dinamo, bashkë me anësorët Hajro Leskaj dhe Fatmir Damo. Në atë kohë gjyqtarët caktoheshin nga FSHF-ja dhe komiteti bënte shpërndarjen e tyre. Ministria e Brendshme kërkonte garantimin e fitores së Dinamos. Unë iu thashë që e marr përsipër ndeshjen, por me kushtin që ndershmëria të jetë e plotë dhe të fitojë ai që do ta meritojë. Nuk pranova kurrsesi që të favorizoja Dinamon, teksa i lashë të hapur një mundësi: nëse loja shkonte 1-0 për Naftëtarin, ndeshjen do e çoja tek penalltitë. Isha i bindur që nuk mund të dilja kundër Naftëtarit. Më konkretisht është rasti i golit, kur unë si

gjyqtar nuk kisha çfarë t'i bëja. Për të qenë i sinqertë, këtë do e bëja, sepse doja të ruaja kokën time. Megjithatë, kjo nuk u realizua, pasi shënoi Dinamo dhe u mbyll gjithçka. Për të shpëtuar nga rënia një kategori më poshtë, Naftëtarit i duheshin për të shënuar edhe tre gola, pasi ndeshja e parë kishte përfunduar 1-0 për Dinamon."

"Lojën e mbylla pa dhënë kohën shtesë"

Porsi shkoi loja dhe kur nisën shkëndijat e para të revoltës? Çfarë vendimesh mori gjyqtari dhe kur mendoi se duhej ta mbyllte lojën? "Loja filloi qetësisht dhe pjesa e parë u bë e fortë dhe e bukur. Rastet për shënim kanë qenë të shumta për Naftëtarin. Nëse ato do të shfrytëzoheshin, do të ishte ndryshe. Më kujtohet që rasti më i pafalshëm ishte i Aleksandër Koçit, ku edhe unë u çudita si nuk u bë gol. Mbjaj mend që portieri i Dinamos ka qenë Ilir Bozhiqi, i cili ka bërë shumë pritje. 45-minutat e para u mbyllën 0-0, ndërsa pjesa e dytë ishte normale deri në minutën e 65-të, kur u shënuar edhe goli. Duke parë që shpresat u humbën për të kthyer rezultatin, që nga ky moment loja u bë agresive. Publiku shante në kor dhe gjuante me gurë. Në minutat e fundit acarimi u bë më i madh. Përtë shmangur incidentet, nuk ia vlente të respektoje minutat shtesë,"- kujton Kaimi.

"Goli i Vilës na shtangu të gjithë"

Ai që preu shpresat e Naftëtarit për të

mbijetuar në kategorinë e parë ishte goli i Arben Vilës në pjesën e dytë. "Goli i Dinamos ishte shumë i pastër. U shënuar me një goditje nga distanca, kështu që nuk kishe kujt t'ia vije fajin. Ka qenë një rivënie anësore dhe topin e ka kapur në mesfushë Ermal Tahiri, i cili pasoi direkt te Arben Vila, që me të majtën nga rreth 30-40 metra, i shtangu të gjithë. Topi shkoi direkt në trekëndëshin e djathtë të portës dhe në këtë moment, sipas rregullores pashë anësorin për ndonjë gjë, por edhe i ngriti supet, sepse goli ishte krejtësisht i rregullt,"- deklaroi ish-gjyqtari, që aktualisht vazhdon punën si vëzhgues i FSHF-së.

"Momenti kur plasi në Kuçovë"

"Menjëherë pasi sinjalizova për përfundimin e ndeshjes, goditjen e parë e morri një mbrojtës i Naftëtarit, i cili u gjakos, pasi e kishte zënë një nga gurët e hedhur nga publiku. Në këtë moment kemi dëgjuar ulërima nga njerëzit. I themi policisë së futemi në dhoma, ndërkohë që aty gjejmë një fëmijë të çarë në kokë dhe të mbushur me gjak. Kujtuam se ai kishte ndërruar jetë. Kur u futëm në dhoma dëgjonim njerëz që thonin sikur kishin vdekur dy vetë. Të them të drejtën në këtë moment u trembëm dhe policia na erdhi në ndihmë. Këto alarme fatmirësisht rezultuan të pavërteta. Ngaqë ishim të izoluar nuk po e kuptonim se çfarë po ndodhte jashtë fushe. Në këtë moment dërgojmë anësorin Hajro Leskaj, që të dilte jashtë për të na blerë ushqim dhe për të mësuar të vërtetën se

çfarë po ndodhte. Më pas morrëm vesh që u dogj makina e zjarrëfikses dhe disa të policisë, gjithashtu kishte dhe njerëz të plagosur nga gurët. Mirëpo dalja e Hajro Leskajt na konfirmoi diçka të rëndësishme, sepse u duk qartë që publiku nuk e kishte me gjyqtarët. Kolegun tonë nuk e ngacmuan fare dhe kjo tregoi se populli nuk kishte gjë me ne. Jashtë stadiumit ishte bërë një krahurë e vërtetë, pasi rruga ishte mbushur me gurë. Pas gjithë asaj revolte, ku pati të lënduar edhe në radhët e policisë, erdhën forcat e rendit nga Tirana, të cilat e morrën situatën në kontroll. Siç e mësuam edhe më vonë, policia në orë të vona të asaj nate arrestoi ata njerëz që ishin iniciatorë të revoltës. Policia na shoqëroi me autokolonë deri në Tiranë, si ne gjyqtarët, ashtu edhe Dinamon. Në Tiranë më priti Mehdi Bushati, Azis Tahiri dhe Kristaq Miço. Treguam ngjarjen dhe më pas iu bë një relacion Ministrisë për gjithçka çfarë ndodhi."

"Sekretari i Beratit më shpëtoi kokën"

"Jam i ndërgjegjshëm që në atë kohë nuk mund të luaja me shtetin. Unë kam qenë në fije të perit, por falë gjyqimit korrekt, shpëtova, dhe nuk u futa në burg. Edhe sot e kësaj ditë, ia di për nder sekretarit të parë të rrethit të Beratit, Abdyl Pilafi, i cili u tregua objektiv në raportimin e ngjarjes. Ministri i Brendshëm, Hekuran Isaji, ka marrë në telefon direkt pas ndeshjes, zotin Pilafi, duke e pyetur: "Bëri gjë gjyqtari? Ndikoi

apo jo në ndeshje?." Dhe përgjigjia e Pilafit ishte kjo: "Absolutisht jo. Gjendja nuk ka ardhur si pasojë e gjyqimit." Që në këtë moment më sollën tre policë në dhomat e zhvjesjes për të më ruajtur nga njerëzit që mund të na godisnin. Ky ka qenë momenti më i vështirë për mua. Tani si përfundim, në gjithë atë revoltë u shfrytëzua futbolli. Politika hyri në mes, sepse të nesërmen zhvillohej edhe Kongresi i Gruas. Unë kurrsesi nuk mund të gaboja, sepse veprimi më i vogël do të më kishte futur në burg. Të gjithë e dimë që shteti i asaj kohe nuk të falte,"- thotë Kaimi për momentet pas ndeshjes, kur Ministri i Brendshëm, Hekuran Isaji, kërkonte të dinte rreth asaj që kishte ndodhur në Kuçovë.

"Në hetuesi kam mbrojtur futbollistët"

Përse u thirr në hetuesinë e Beratit Besnik Kaimi? "Një ditë pas ndeshjes më thirrën në hetuesinë e Beratit. Përveç meje janë pyetur edhe rreth 300 vetë. Shteti i asaj kohe donte të dinte nga kush ka ardhur revolta, nga futbollit, apo nga situata e rënduar ekonomike. Në hetuesi më pyetën për ata futbollistë që ishin ndëshkuar me kartonë të verdhë, por unë i thashë që ata nuk janë shkaktarët e ngjarjes, dhe nuk duhet të mereni me ta. Futbollistët u dënuan me kartonë për atë çka bënë gjatë lojës. Iu thashë që brenda fushës 90-minutat kanë qenë pa probleme. U kuptua qartë që futbollistët nuk kishin lidhje me situatën dhe kurrsesi nuk kishte arsye pse të merreshin me ta."

Ish-portieri i Naftëtarit dhe Dinamos, Ilir Bozhiqi, flet si protagonist i ndeshjes së "famshme"

Bozhiqi: Babai më kërkoi që të mos luaja

Më shumë se kushdo, ndeshjen e 5 qershorit të vitit 1988, Naftëtari-Dinamo, e ka përjetuar ish-portieri i kësaj të fundit, Ilir Bozhiqi. Jo vetëm se ishte nga Kuçova, por fakti që në këtë përballje duhet të mbronte portën e Dinamos, do të thoshte shumë për të. Ai flet për ndeshjen e "famshme", duke treguar disa nga momentet kulmore dhe përjetimin e revoltës nga dhomat e zhvjesjes.

- Ilir, u bënë 20 vjet nga ndeshja e "famshme" Naftëtari-Dinamo, çfarë kujtoni?

- Edhe pse kanë kaluar shumë vjet, përsëri e ruaj si një kujtim të veçantë. Duke qenë se në ndeshjen e parë në Tiranë fituam 1-0, në një lojë të bukur, Naftëtari ishte i karikuar për të

përmbysur rezultatin, në mënyrë që të ngjitesh në kategorinë e parë. Ndeshja u zhvillua në orën 17:00, ndërkohë që stadiumi ishte i tejmbushur. Ne kishim kaluar një sezon shumë të vuajtur dhe me plot probleme, por megjithatë u nisëm drejt Kuçovës me bindje të plotë se do t'ia dilnim mbanë.

- Si kanë qenë ditët para ndeshjes dhe a ju kanë bërë presion, duke qenë edhe vetë nga Kuçova?

- Para ndeshjes kemi qenë disa ditë të grumbulluar në Durrës (Kavalishencë), por ishim disi të çakorduar, pasi nuk na besohej që do shkonte puna deri këtu. Nga vendi katërt në muajin mars, përfunduam në fund të tabelës në maj. Kjo ishte e papranueshme për Dinamon. Mbjaj mend që një ditë para ndeshjes shkuam

në Berat. Në hotel më erdhi babai dhe më ka kërkuar të mos luaja, në mënyrë që ndeshja mos acarohet, duke ditur që unë isha djalë i Kuçovës. Mirëpo, unë isha futbollist i Dinamos dhe vërtet me shpirt doja që Naftëtari të ishte sa më lart, por në këtë rast nuk kisha çfarë të bëja. Pra, do të luaja për Dinamon, së cilës i jam përkushtuar gjithë karrierës sime.

- Çfarë ndodhi pas ndeshjes dhe a patët ngacmime nga tifozët?

- Ne si futbollistë shumë pak dëgjuam se çfarë ndodhi jashtë stadiumit, sepse pas ndeshjes mbetëm të izoluar. Mund të them se nga ora 19:00, kur përfundoi ndeshja, e deri në 24:00 të natës, kemi qenë të mbyllur në dhomat e zhvjesjes. Ne thjesht dëgjonim nga jashtë, ulërima njerëzish dhe vetëm

kaq. U mblodhën shumë njerëz jashtë stadiumit, duke bërtitur "Vdekje Fashizmit" dhe thirrje të tjera. Por, në asnjë mënyrë tifozët nuk na sulmuan neve. Kur ishim në dhoma na bërën thirrje për qetësi. Mbjaj mend, që një miku im më sollti dy bukë dhe djathë, për të shtyrë sadopak orët e "ngujimit".

- Si mund të largoheshit nga stadiumi drejt Tiranës?

- Në orën 24:00 erdhi policia, e cila na shoqëroi drejt Tiranës me 6 makina. Ne si futbollistë kemi hipur në IFA-t e asaj kohe, pasi autobusit të klubit i kishin thyer xhamat. Udhëtimi ka qenë pa probleme, ndërkohë që dua të them se në atë kohë u diskutua sikur kishte shumë forca speciale, por nuk ishte e vërtetë.